

Të nderuar,

Kam kënaqësinë të jem sot këtu për të diskutuar dhe për të dëgjuar rreth një tematike shumë të rëndësishme për ekonominë e vendit tonë, me ç ‘rast dëshiroj të shpreh vlerësimin tim të lartë për Shoqatën e Bankave të Kosovës e cila çdo ditë e më tepër avancoon përfaqësimin e sektorit bankar të Kosovës në çdo aspekt.

Tema e kësaj konference konsideroj se është shumë e qëlluar sepse vjen në një kohë kur sektori bankar ka shënuar progres mjaft të rëndësishëm në përmirësimin e kushteve për financim të qëndrueshëm të ekonomisë.

Sektori bankar i Kosovës, në vitet e fundit ka rritur në masë të konsiderueshme rolin e tij në financimin e rritjes ekonomike në vend, duke përshpejtuar ritmin e rritjes së kredive, si dhe duke zvogëluar në masë të konsiderueshme normat e interesit në kredi. Standardet më të lehtësuara kreditore dhe zvogëlimi i normave të interesit në kredi kanë shërbyer si stimuj të rëndësishëm për rritjen e kërkesës për kredi, duke rezultuar në një rritje vjetore të kredive prej 11.6 përqind në muajin tetor të këtij viti. Kjo tregon se qasja në financa, e cila për një kohë të gjatë është raportuar nga bizneset si njëra ndër barrierat kryesore për zhvillimin e afarizmit të tyre, tani po shënon përmirësim të vazhdueshëm. Kjo mund të vërehet edhe nga rritja e kreditimit për sektorët e ekonomisë të cilët në periudhat paraprake kanë pasur qasje më të kufizuar në financimin bankar. Si shembull konkret mund të merren sektori i bujqësisë dhe sektori i prodhimit, të cilët në vitin e fundit ka qenë ndër sektorët me rritjen më të lartë të kredive të pranuar. Megjithatë, shuma e përgjithshme e kredive të lëshuara për këta sektorë vazhdon të jetë ende e ulët. Në tetor 2018, kreditë për sektorin e bujqësisë kishin pjesëmarrje prej 3.8% në gjithsej kreditë për ndërmarrjet, ndërsa kreditë për sektorin e prodhimit të përfaqësuan

12.7% të gjithsej kredive. Me që edhe tema e sotme ka të bëjë me rolin e sektorit bankar në financimin e zhvillimit, dëshiroj ta potencoj faktin se mbështetja më e madhe për këta sektorë të ekonomisë, por edhe për sektorët tjerë me potencial më të madh për të gjeneruar rritje ekonomike, është e domosdoshme për të pasur një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik.

Mirëpo, ne po ashtu jemi të vetëdijshëm se diversifikimi i portofolit kreditor të sektorit bankar nuk varet vetëm nga ana e ofertës për kredi, por në masë të madhe varet edhe nga kërkesa për kredi. Në këtë kontekst, dëshiroj të theksoj se bankat kanë potencial mjaft të lartë financiar për rritje të mëtejme të kreditimit, kanë lehtësuar standardet kreditore, si dhe kanë zvogëluar në masë të konsiderueshme koston e qasjes në financim bankar. Në tetor 2018, norma mesatare e interesit në kredi ishte 6.6%, që paraqet një përmirësim shumë të madh në krahasim me një periudhë jo shumë të largët. Këta tregues tregojnë se oferta për kredi është përmirësuar në masë të konsiderueshme. Sidoqoftë, për të pasur një kreditim më të madh të sektorëve që aktualisht kanë qasje më të ulët në financimin bankar nuk mjafton vetëm përmirësimi i ofertës për kredi, por gjithashtu nevojitet që kërkesa e këtyre sektorëve për kredi të jetë më e lartë dhe me cilësi më të mirë. Me këtë dua të them se nevojitet një qasje më gjithëpërfshirëse për të identifikuar dhe për të mbështetur zhvillimin e sektorëve me rëndësi më të madhe për zhvillimin ekonomik të vendit.

Një hap i rëndësishëm për rritjen e mbështetjes për këta sektorë vlerësojmë se është ndërmarrë me themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Deri më tani, gjithsej vlera e kredive që janë të garantuara nga ky Fond ka arritur në 71.3 milionë euro dhe është shpërndarë në 1,836 ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme. Megjithatë, struktura e kredive, sipas sektorëve të ekonomisë, të garantuara nga ky Fond vërehet se është mjaft e ngjashme me strukturën e kredive të pagantuar, ku

dukshëm dominojnë kreditë për sektorin e tregtisë. Prandaj, me qëllim që t'i shërbejë sa më mirë qëllimit për të cilin është themeluar, ne presim që Fondi Kosovar për Garanci Kreditore të luaj një rol edhe më të madh në rritjen e financimit kreditor për sektorët me qasje më të ulët në financimin bankar, por me rëndësi të madhe për të pasur një zhvillim më të madh ekonomik.

Për të pasur një sektor bankar në funksion të financimit të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik të vendit, parakusht themelor është që sektori të jetë i qëndrueshëm. Me këtë rast, dëshiroj të konfirmoj përsëri që sektori bankar i Kosovës vazhdon të jetë i qëndrueshëm bazuar në të gjithë treguesit e shëndetit financiar. Vëmendje të veçantë dëshiroj t'i kushtoj cilësisë shumë të mirë të portofolit kreditor, e cila flet për menaxhim të mirë të rrezikut kreditor nga bankat, por lirisht mund të shërbejë edhe si një indikator i rëndësishëm i ambientit të favorshëm ekonomik për operimin e bankave në Kosovë. Në muajin shtator të këtij viti, norma e kredive joperformuese ishte 2.8%, gjë që pasqyron një gjendje shumë të mirë të cilësisë së portofolit kreditor. Gjendja e kënaqshme e qëndrueshmërisë së sektorit bankar paraqitet edhe nga treguesit tjerë, siç janë treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit dhe ai i likuiditetit, të cilët në vazhdimësi kanë tejkaluar kërkesat rregullatore dhe paraqesin aftësinë e lartë paguese të sektorit bankar.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me të gjitha kapacitetet e saj është në funksion të mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm të sistemit financiar, duke e ofruar të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të mbështetur zhvillimin e institucioneve financiare dhe në të njëjtën kohë duke u siguruar se veprimtaria e

tyre siguron stabilitet financiar. Në këtë aspekt, ne jemi duke i ofruar sektorit bankar standardet më bashkëkohore të rregullativës dhe mbikëqyrjes financiare, duke bërë që bankat dhe institucionet tjera financiare në Kosovë të operojnë në bazë të rregullave që janë në fuqi në të gjitha vendet e zhvilluara. Po ashtu, BQK-ja i ofron sektorit bankar një infrastrukturë moderne financiare. Sistemi i pagesave ndërbankare, një sistem modern, efikas dhe i sigurt, si dhe regjistri i kredive që i ofron bankave shërbimet më moderne në këtë fushë, paraqesin shembuj të mirë për të ilustruar zhvillimin e infrastrukturës financiare në Kosovë.

Në vitet e fundit, BQK-ja ka rritur angazhimin e saj edhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare, duke i shërbyer kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjes së interesit të publikut. Aktivitetet e edukimit financiar paraqesin një pjesë shumë të rëndësishme të këtij angazhimi, duke e pasur për qëllim informimin sa më të qartë të publikut mbi mundësitë që i ofron sistemi financiar, por edhe mbi të drejtat që ata i gëzojnë gjatë shfrytëzimit të shërbimeve financiare. Me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave të qytetarëve dhe bizneseve, ne kemi hartuar rregulloren mbi shpalosjen e informacionit nga bankat, si dhe kemi zhvilluar divizionin për trajtimin e ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare, i cili trajton të gjitha ankesat ndaj institucioneve financiare.

BQK-ja, që nga fillimi i funksionimit të saj, gjithmonë ka qenë dhe është në mbështetje të plotë të zhvillimit të sistemit financiar, por dëshiroj të theksoj se ne jemi të përkushtuar që të sigurohemi se zhvillimi i institucioneve financiare të bëhet në përputhje të plotë me parimet e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve. Në këtë aspekt, ne jemi të vendosur që të rrisim edhe më tutje angazhimin tonë në

mbrojtje të të drejtave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare dhe kërkoj nga bankat që të shqyrtojnë me kujdes kërkesat ligjore dhe politikat e tyre për të shmangur çdo pengesë të paarsyeshme, e cila vështirëson ndërveprimin normal ndërmjet qytetarëve dhe sektorit bankar.

Ne angazhohemi dhe presim që zhvillimi i vazhdueshëm i sektorit bankar të krijojë kushte për qasje më të lehtë dhe me kushte më të favorshme për qytetarët dhe bizneset në shërbimet bankare. Kjo është në linjë edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të hartuara nga Kombet e Bashkuara, ku në kuadër të objektivit për rritje ekonomike në nivel global theksohet qartë nevoja e përmirësimit të qasjes në shërbimet financiare për të siguruar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike.

Në përmbyllje të fjalës sime, dëshiroj edhe një herë të theksoj se sektori bankar i Kosovës është në gjendje të shëndoshë financiare dhe me rritje të vazhdueshme të financimit të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës, por kërkohet një angazhim edhe më i madh ndërinstitucional për të krijuar kushtet e nevojshme që mbështetja e këtij sektori për ekonominë e vendit të jetë edhe më e madhe.

BQK-ja do të vazhdojë të mbështesë të gjitha aspektet e zhvillimit të sektorit bankar, duke ofruar të gjithë infrastrukturën e nevojshme si financiare ashtu edhe rregullatore. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet BQK-së dhe sektorit bankar, i lehtësuar në masë të madhe nga Shoqata e Bankave të Kosovës, na ka mundësuar që të adresojmë në mënyrë më efektive nevojat për zhvillimin dhe ruajtjen e stabilitetit të sektorit, prandaj ne jemi të përkushtuar që bashkëpunimin tonë konstruktiv ta avancojmë edhe më tutje.